



Kushdo që udhëzon dikë për një punë të mirë, do ta ketë shpërblimin të njëjtë sikurse ai që e bën atë punë

Ebu Mesud Ensariu (Allahu goftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Një person erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "Më ka ngordhur kafsha, andaj a mund të më gjesh një kafshë për udhëtim (për në betejë)?" Ai ﷺ tha: "Nuk kam." Një person tjetër tha: "O i Dërguari i Allahut, unë do ta drejtoj te dikush që do t'i gjejë kafshë udhëtimi." I Dërguari i Allahut ﷺ tha: "Kushdo që udhëzon dikë për një punë të mirë, do ta ketë shpërblimin të njëjtë sikurse ai që e bën atë punë."

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Një njeri erdhi te Profeti ﷺ dhe i tha: "Kafsha kalëruese më ka ngordhur, andaj a mund të më gjesh një kafshë për udhëtim, që të më dërgojë (për ku jam nisur)." Profeti ﷺ i kërkoi falje sepse nuk kishte asnjë kafshë për ta bartur, kështu që një person që ishte i pranishëm tha: "O i Dërguari i Allahut, unë do ta drejtoj te dikush që do t'i gjejë kafshë udhëtimi." Kështu, i Dërguari i Allahut ﷺ e lajmëroi se ai ishte ortak në shpërblim me atë që do t'ia japë kafshën e udhëtitimit, sepse nevojtarin e drejtoi tek ai.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5354>

